



**“Diversifikimi i zërave në Gazetari”
Grantet për media
Dokument me pyetje e përgjigje**

Ky dokument përfshin një listë jo shteruese të pyetjeve që K2.0 ka pranuar lidhur me [thirrjen për aplikime për grante](#), i publikuar më 25 mars 2024, si pjesë e projektit të financuar nga BE “Diversifikimi i zërave në gazetari”. Për hir të qartësisë dhe transparencës, K2.0 ka grumbulluar pyetjet më të rëndësishme që ka marrë, së bashku me përgjigjet e tyre.

1. A duhet të publikohen produksionet e realizuara si pjesë e projektit tonë në revistën Kosovo 2.0 apo diku tjetër?

Udhëzimet për thirrjen specifikojnë se rezultatet e projektit duhet të shpërndahen në internet, veçanërisht në faqet e internetit apo platformat e mediave sociale të mediave/OJQ fituese ose në platformat e mediave partnere, kur është e aplikueshme. Për të siguruar shpërndarje të gjerë tek publiku, aplikuesit që nuk janë medie duhet ta parashikojnë krijimin e partneriteteve me medie të tjera për shpërndarjen e rezultateve të projektit. Në kuadrin e kësaj thirrjeje, K2.0 operon si subgrantues. Prandaj, nuk duhet të konsiderohet partner medial. Rrjedhimisht, ne as nuk kërkojmë dhe as nuk pranojmë që produksionet e mbështetura të planifikohen për t'u botuar në revistën tonë në fazën e aplikimit.

2. Organizata ime tashmë ka marrë mbështetje të granteve mediale si pjesë e projektit “Diversifikimi i zërave në Gazetari”. A mund të aplikoj përsëri?

Siç thuhet në [udhëzimet e thirrjes së vitit të kaluar](#), "pasi të jepet një grant, një subjekt specifik nuk mund të aplikojë sërish apo të marrë fonde shtesë në kuadër të këtij aktiviteti". Kjo do të thotë se subjektet që kanë marrë tashmë mbështetje si pjesë e këtij projekti nuk do të mund të marrin fonde shtesë në kuadër të projektit “Diversifikimi i zërave në gazetari”. Kjo politikë është krijuar për të siguruar që mbështetja të arrijë tek subjekte të ndryshme sa më shumë që të jetë e mundur.

3. Bashkë me kolegë/e nga fusha e gazetarisë, dëshirojmë të aplikoj si grup joformal për të përfituar mbështetje financiare në kuadër të kësaj thirrjeje. A i plotësojmë kushtet?

Thirrja nuk parashikon kufizime lidhur me datën e themelimit të subjekteve aplikuese. I kemi larguar qëllimisht kufizimet e tilla, duke pranuar se data e themelimit nuk pasqyron gjithmonë përvojën dhe ekspertizën e një OJQ, subjekti medial privat ose nismë të peregjistruar. Qëllimi i kësaj thirrjeje është t'i mbështesë gjithashtu subjektet e reja, të cilat, për shkak të themelimit të tyre së fundmi, mund t'i hasin vështirësi për t'i qasur burimet e rregullta të financimit dhe trajnimit. Sidoqoftë, aplikuesit duhet të kenë parasysh:



- a. Mundësitë e financimit, duke përfshirë këtë, synojnë të sigurojnë që burimet e disbursuara mund të kenë ndikim të qëndrueshëm dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të subjekteve përfituese. Rrjedhimisht, subjektet që krijohen vetëm për qëllimin e sigurimit të mbështetjes financiare zakonisht nuk janë në gjendje ta dëshmojnë stabilitetin e nevojshëm për të marrë fonde gjatë fazës së vlerësimit.
- b. Individët, duke përfshirë grupe individësh, nuk kanë të drejtë të marrin fonde sipas kësaj thirrjeje. Prandaj, nismat e peregjistruara nuk duhet të jenë thjesht grupime individësh. Njësoj si subjektet e regjistruara dhe përveç sigurimit të mbështetjes nga një subjekt i regjistruar që vepron si sponsor fiskal, nismat e peregjistruara duhet të dëshmojnë një vizion të qartë, mision dhe operacione domethënëse në fazën e aplikimit.

4. Pamë se formularët e aplikimit të ofruara nga K2.0 janë vetëm në gjuhën angleze. A do të thotë kjo se duhet t'i plotësojmë në gjuhën angleze, apo mund t'i plotësojmë edhe në shqip?

Siç thuhet në udhëzimet e thirrjes, aplikimin tuaj mund ta shkruani në shqip, serbisht ose anglisht. Për ta lehtësuar procesin tonë të vlerësimit, preferojmë të marrim aplikime në anglisht. Megjithatë, gjuha që përdorni për aplikim nuk do të ndikojë në vlerësim. Nëse vendosni ta shkruani aplikimin në anglisht, e kemi parasysh se gjuha angleze mund të mos jetë gjuha juaj amtare. Prandaj, për sa kohë që propozimi të jetë i qartë, nuk duhet të shqetësoheni për nivelin tuaj të njohjes së gjuhës angleze.

Për ta përmbledhur, megjithëse formularët e aplikimit ofrohen vetëm në anglisht, e keni mundësinë t'i plotësoni ato në gjuhën shqipe. Ju lutemi ta keni parasysh se nëse përzgjidhni, procedurat administrative të programit të granteve mediale do të kryhen në gjuhën angleze.

5. Jemi OJQ e themeluar në vitin 2022 dhe prodhimet mediale nuk figurojnë si aktivitet në statutin tonë. A kemi të drejtë të marrim pjesë në këtë thirrje?

Siç thuhet në udhëzimet e thirrjes, OJQ që plotësojnë kushtet janë organizatat mediale ose ato që kanë kapacitet, arsye ose përvojë të dëshmuar në prodhimin e përmbajtjeve mediale. Kjo nënkupton se nuk ka kufizime lidhur me datën e themelimit të OJQ. OJQ që plotësojnë kushtet përfshijnë organizata që, përkundër mungesës së përvojës së mëparshme në prodhime mediale, kanë kapacitet dhe arsye për t'u përfshirë në aktivitete të tilla. Megjithatë, këto organizata duhet ta kenë parasysh se thirrja i jep përparësi mbështetjes së qëndrueshme punës së pavarur dhe të larmishme mediale në Kosovë. Prandaj, organizatat duhet ta dëshmojnë me kujdes aftësinë e tyre për t'u angazhuar në prodhimet mediale dhe rëndësinë e aktiviteteve të tilla brenda strategjive dhe programeve të tyre organizative, si tani ashtu edhe në të ardhmen. Për më tepër, organizatat inkurajohen fuqimisht të bashkëpunojnë me subjektet mediale për zbatimin e projektit. Ky bashkëpunim i shërben dy objektivave kryesore të thirrjes: sigurimin e ndikimit dhe qasjen e gjerë në prodhime mediale, si dhe mbështetjen e ekosistemit medial kosovar.



Për më tepër, aplikuesve nuk u kërkohet ta ofrojnë statutin e tyre në fazën e aplikimit. Është përgjegjësi vetëm e aplikuesit të sigurojë që aktivitetet e përshkruara në projekt propozimin e tyre të përputhen me statutin e tyre dhe dokumentet e tjera organizative.

6. Si OJQ e fokusuar kryesisht në aktivitete të tjera përveç prodhimeve mediale, ne planifikojmë të bashkëpunojmë me një subjekt medial për zbatimin e projektit tonë. A duhet ta përfshijmë një memorandum bashkëpunimi me këtë subjekt medial si pjesë e aplikimit tonë?

Për subjektet që dëshirojnë të paraqesin një propozim si pjesë e një konsorciumi, është qenësore që kjo të tregohet qartë në formularin e aplikimit. Kjo përfshin plotësimin e rubrikës së dedikuar (d.m.th, rubrikën "Informacionet e bashkë-aplikuesit") dhe përshkrimin e plotë të natyrës së bashkëpunimit në rubrikën "Përshkrimi i aplikantit". Ngjashëm, organizatat që parashikojnë forma më të lirshme të bashkëpunimit me palët e treta duhet të japin shpjegime të hollësishme në përshkrimin e projektit, veçanërisht në rubrikën "Aktivitetet e projektit". Në këtë kontekst, juria do të mbështetet vetëm në formularin e aplikimit për të kuptuar subjektet e përfshira në projekt propozimin dhe për të vlerësuar bashkëpunimin e tyre. Prandaj, edhe pse përfshirja e një memorandum bashkëpunimi në dosjen e aplikimit vlerësohet, nuk është e detyrueshme.

Mbi të gjitha, është përgjegjësi e aplikuesit ta përcaktojë llojin dhe masën e bashkëpunimit me palët e treta që kërkon që propozimi i tyre të jetë bindës dhe në përputhje me prioritetet e thirrjes dhe ta artikulojë këtë me saktësi. Kur aplikoni si pjesë e një konsorciumi, kjo do të thotë ta shqyrtoni me kujdes, bazuar në prioritetet e thirrjes, kapacitetin organizativ të çdo subjekti të përfshirë dhe aktivitetet e propozuara të projektit, organizatën më të përshtatshme për të udhëhequr konsorciumin.

7. A mund të përfshijë projekt propozimi ynë aktivitete përtej Kosovës? Për shembull, a lejohet të bëjmë hulumtime në Shqipëri dhe më pas t'i publikojmë në platformën tonë në Kosovë?

Projektet që plotësojnë kushtet duhet të dorëzohen nga aplikuesit me bazë në Kosovë, të cilët në propozimet e tyre kanë prioritet shërbimin për audiencën kosovare. Përderisa aplikuesit mund të propozojnë aktivitete që mbulojnë vendet, ngjarjet dhe çështjet përtej Kosovës, ata/o duhet të sigurojnë që audiencia kosovare të mbetet fokusi i tyre kryesor. Kjo përfshin priorizimin e audiencës kosovare në platformat e shpërndarjes dhe arsyetimin, gjatë fazës së aplikimit, se si mbulimi i çështjeve të jashtme është i rëndësishëm për audiencën kosovare. Derisa aplikuesit/et mund të propozojnë aktivitete që shtrihen përtej Kosovës, ata/o duhet gjithashtu të dëshmojnë se si propozimi i tyre siguron që Kosova të mbetet fokusi qendror në aspektet redaktoriale, implementuese dhe financiare të aktiviteteve të tyre.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi konsultoni [dokumentin me pyetje e përgjigje](#) të vitit të kaluar, pasi të gjitha përgjigjet e dhëna atje janë të rëndësishme edhe për thirrjen e këtij viti.